



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 7404 prot.

Pogradec, më 10 06 .2026

VENDIM
NR. 75, DATË 09 .06 .2026
PËR
MIRATIMIN E HARTËS TË HAPËSIRAVE PUBLIKE NË BASHKINË
POGRADEC

Në mbështetje të nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 4/1 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, relacionit të Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë hartën e hapësirave publike në territorin e Bashkisë Pogradec, sipas materialit hartografik bashkëlidhur.
2. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 për “Miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”, shfuqizohet.



3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 2

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 09.06.2026